



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1578 Prot.

Tiranë, më 22.12 2017

VENDIM Nr. 244, datë 13.12.2017

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.13, datë 13.12.2017, pasi shqyrtoi Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të projektit "*Ndërtimi i Fabrikës së pasurimit dhe damba sterilizimit*" në ish Zonën II Minerare të Bakrit në Gurth Spaç Rrëshen/Lezhë - subjekti "Tete Albania Tunnel & Mining" sh.p.k. realizuar nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k.,

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të projektit "*Ndërtimi i Fabrikës së pasurimit dhe damba sterilizimit*" në ish Zonën II Minerare të Bakrit në Gurth Spaç Rrëshen/Lezhë - subjekti "Tete Albania Tunnel & Mining" sh.p.k. realizuar nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k.
2. Subjekti "Tete Albania Tunnel & Mining" sh.p.k. duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili duhet të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit për projektin "*Ndërtimi i Fabrikës së pasurimit dhe damba sterilizimit*" në ish Zonën II Minerare të Bakrit në Gurth Spaç Rrëshen/Lezhë si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë shoqëri.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR


SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO


Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al